Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo

Zyra Kombëtare e Auditimit
Nacionalna Kancelarija Revizije
National Audit Office

RAPORTI I AUDITIMIT PËR PASQYRAT FINANCIARE VJETORE PËR VITIN 2019

TË NDËRMARRJES PUBLIKE "HEKURUDHAT E KOSOVËS" – TRAINKOS SH.A

Prishtinë, korrik 2020

RAPORTI I AUDITORIT TË PËRGJITHSHËM

Për: Ministrin e Ekonomisë dhe Ambientit z. Blerim Kuçi,

Bordin e Drejtorëve të Trainkos sh.a. z. Ramush Ahmetaj

Kryeshefin Ekzekutiv z. Gelor Shala

Zyrtarin Kryesor të Financave dhe Thesarit z. Durim Krasniqi

Adresa: Sheshi i Lirisë p.n. Fushë Kosovë

1.1 Opinioni i auditimit për Pasqyrat Financiare Vjetore të Trainkos Sh.a.

Ne kemi kryer auditimin e Pasqyrave Financiare Vjetore (PFV) për vitin 2019 të Ndërmarrjes Publike "Hekurudhat e Kosovës"- Trainkos sh.a. (më tutje Trainkos) të cilat përfshijnë pasqyrën e pozitës financiare, pasqyrën e të ardhurave gjithëpërfshirëse, pasqyrën e rrjedhës së parasë së gatshme, pasqyrën e ndryshimeve në ekuitet dhe shënimet shpjeguese për pasqyrat financiare, përfshirë përmbledhjen e politikave të rëndësishme kontabël.

2. Opinion i kualifikuar

Sipas opinionit tonë, përveç efektit të çështjeve të përshkruara në paragrafin për Bazën për Opinion të Kualifikuar, Pasqyrat Financiare të bashkangjitura për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2019, prezantojnë një pamje të drejtë dhe të vërtetë në të gjitha aspektet materiale të pozitës financiare të Trainkos deri me 31 dhjetor 2019, performancës së saj, si dhe rrjedhës së parasë së gatshme për vitin 2019, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF). Transaksionet janë kryer në pajtim me rregullat dhe rregulloret financiare, të aplikueshme për ndërmarrjet publike.

Baza për opinion të kualifikuar

1. Sipas Standardit Ndërkombëtar të Kontabilitetit - SNK 16, rivlerësimi i pasurive jo qarkulluese kërkohet të bëhen çdo tre deri në pesë vjet, që të sigurohet se vlera kontabël (neto) e aktivit nuk ndryshon materialisht nga ajo që do të përcaktohej nëse do të përdorej vlera e drejtë në fund të periudhës raportuese.

   Trainkos në pasqyrën e pozitës financiare ka prezantuar pasuri jo qarkulluese (prona, pajisje dhe impiante) në vlerë neto 4,816,819€ për të cilat për herë të fundit e kishte realizuar një rivlerësim në vitin 2007. Andaj ne nuk ishim në gjendje të konstatojmë nëse vlera e pasurive jo qarkulluese është e saktë, apo e mbi/nënvlerësuar.

   Çështja e rivlerësimit të pasurive jo qarkulluese, ishte trajtuar edhe në raportin e auditimit financiar për vitin 2018, mirëpo sipas zyrtarëve të Trainkos-it rivlerësimi i pasurisë nuk ishte

bërë në mungesë të fondeve për të financuar një kompani të licencuar për rivlerësimin e pasurive.

Përgjegjësitë e menaxhmentit për Pasqyrat Vjetore Financiare

Menaxhmenti është përgjegjës për përgatitjen dhe prezantimin e drejtë të Pasqyrave Financiare sipas Standardeve Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF). Po ashtu, menaxhmenti është përgjegjës për vendosjen e kontrolleve të brendshme, të cilat i përcakton si të nevojshme për të mundësuar përgatitjen e pasqyrave financiare pa keqdeklarime materiale të shkaktuara, qoftë nga mashtrimi apo gabimi. Kjo përfshinë gjithashtu zbatimin e Ligjit nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (me plotësime dhe ndryshime), Ligjit nr. 04/L-087 për Ndërmarrjet Publike (me plotësime dhe ndryshime), dhe Ligjit 06/L-032 për Kontabilitet, Raportim Financiar dhe Auditim.

Menaxhmenti është po ashtu përgjegjës për kryerjen e transaksioneve financiare në pajtim me kornizën e aplikueshme ligjore.

Bordi i Drejtorëve është përgjegjës për mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Trainkos sh.a.

Përgjegjësia e Auditorit të Përgjithshëm për auditimin e PFV-ve

Objektivat tona janë të marrim siguri të arsyeshme se Pasqyrat Financiare janë në tërësi të lira nga keqdeklarimi material, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit, dhe kështu të nxjerrim një raport të auditorit që përfshinë opinionin tonë. Siguria e arsyeshme është niveli i lartë sigurie, por nuk garanton se një auditim i kryer në përputhje me SNISA-t do të zbulojë çdoherë keqdeklarimet materiale që ekzistojnë. Keqdeklarimet mund të rezultojnë nga mashtrimi ose gabimi dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose së bashku, me arsye pritet qe të ndikojnë në vendimet ekonomike të përdoruesve, të marra në bazë të këtyre Pasqyrave Financiare.

Si pjesë e auditimit, në përputhje me SNISA-t, ne ushtrojmë gjykimin profesional dhe mbajmë skepticizëm profesional gjatë gjithë auditimit. Ne gjithashtu:

- Identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e keq-deklarimit material të Pasqyrave Financiare, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit, hartojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit konform atyre rreziqeve, si dhe sigurojmë dëshmi të auditimit që janë të mjaftueshme dhe të duhura për të siguruar bazën për opinionin tonë. Rreziku i moszbulimit të një keqdeklarimi material që rezulton nga mashtrimi është më i lartë sesa për keqdeklarimin që rezulton nga gabimi, pasi mashtrimi mund të përfshijë manipulimin, falsifikimin, lëshime të qëllimshme, keqpërfaqësime apo anashkalimin e kontrollit të brendshëm.

- Sigurohemi ta kuptojmë kontrollin e brendshëm relevant për auditimin, për t'i hartuar procedurat e auditimit që janë të përshtatshme në rrethanat, por jo me qëllim të shprehjes së opinionit për efikasitet të kontrollit të brendshëm të Ndërmarrjes.

- Vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave të përdorura kontabël dhe arsyeshmërinë e vlerësimeve të kontabilitetit dhe shpalosjet përkatëse të bëra nga menaxhmenti.
- Nxjerrim një përfundim nëse baza e vijimësisë së kontabilitetit është e përshtatshme për përdorim nga menaxhmenti, bazuar në provat e siguruara të auditimit, nëse ekziston pasiguria materiale në lidhje me ngjarje apo kushte që mund të hedhin dyshime të rëndësishme në aftësinë e ndërmarrjes, për të vazhduar sipas parimit të vijimësisë. Nëse konkludojmë se ekziston një pasiguri materiale, nga ne kërkohet që të tërheqim vëmendjen në raportin tonë të auditimit për shpalosjet përkatëse në Pasqyrat Financiare ose, nëse zbulimet e tilla janë të papërshtatshme ta modifikojmë opinionin tonë. Përfundimet tona bazohen në provat e auditimit të marra deri në datën e raportit tonë të auditimit. Sidoqoftë, ngjarjet apo kushtet e ardhshme mund të bëjnë që Kompania të pushojë së vazhduari sipas parimit të vijimësisë.
- Vlerësojmë prezantimin e përgjithshëm, strukturën dhe përmbajtjen e Pasqyrave Financiare, përfshirë edhe shpalosjet, për t'u siguruar se Pasqyrat Financiare paraqesin transaksionet dhe ngjarjet në mënyrë të drejtë dhe të saktë.

Ne komunikojmë me menaxhmentin e entitetit të audituar në lidhje me fushëveprimin, kohën e planifikuar të auditimit dhe gjetjet e rëndësishme të auditimit, përfshirë ndonjë mangësi të rëndësishme në kontrollin e brendshëm që ne e identifikojmë gjatë auditimit.

Ne, gjithashtu i ofrojmë menaxhmentit deklaratën qe ne i kemi zbatuar kërkesat përkatëse etike lidhur me pavarësinë, dhe iu komunikojmë atyre të gjitha marrëdhëniet dhe çështjet e tjera që në mënyrë të arsyeshme mund të mendohet se vënë në dyshim pavarësinë tonë, si dhe masat mbrojtëse, aty ku është e zbatueshme. Nga çështjet e komunikuara me menaxhmentin, ne përcaktojmë ato çështje që ishin më të rëndësishme në auditimin e Pasqyrave Financiare të periudhës aktuale dhe që cilësohen si çështje kyçe të auditimit. Ne i përshkruajmë këto çështje në raportin e auditimit.

Raporti i auditimit publikohet në ueb faqen e ZKA-së, me përjashtim të informacioneve që klasifikohen si sensitive apo për shkak të ndalesave të tjera ligjore e administrative, në pajtim me legjislacionin në fuqi.

2 Gjetjet dhe Rekomandimet

Ne kemi kryer auditimin e Pasqyrave Financiare Vjetore të Trainkos për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2019, në përputhje me Ligjin për Auditorin e Përgjithshëm dhe Zyrën Kombëtare të Auditimit si dhe Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit. Ekzaminimet e auditimit janë kryer për të na mundësuar dhënien e opinionit për Pasqyrat Financiare Vjetore.

Lëndë të auditimit kanë qenë edhe efektiviteti i sistemit të kontrollit të brendshëm, si dhe pajtueshmëria me kornizën ligjore dhe rregullative, por jo për qëllime të dhënies së opinionit.

Gjetjet dhe rekomandimet e përfshira në këtë pjesë kanë për qëllim përmirësimin e raportimit financiar dhe evitimin e dobësive në sistemin e kontrollit të brendshëm. Megjithatë, çështjet e ngritura në këtë raport nuk mund të konsiderohen si një pasqyrim i plotë i të gjitha dobësive që ekzistojnë ose të gjitha përmirësimeve që mund të bëhen.

Ne po ashtu, kemi rishikuar statusin e rekomandimeve të vitit paraprak dhe kemi vlerësuar nivelin e zbatimit të tyre. Për detajet shih tabelën nr. 1 në shtojcën II.

Zyra Kombëtare e Auditimit vlerëson bashkëpunimin e menaxhmentit dhe personelit të Trainkos gjatë zhvillimit të procesit të auditimit.

1.2 Rekomandimet për opinionin

Rekomandimi B1 [1] Bordi i drejtorëve të sigurojë një rishikim gjithëpërfshirës të regjistrit të pasurisë dhe të ndërmarrë veprime konkrete për rivlerësimin dhe rishikimin e jetës së dobishme të pasurive së paku një herë në (5) pesë vite. Kjo me qëllim të paraqitjes së vlerës reale të pasurive, në përputhje me kërkesat e SNK 16.

Përgjigjja e menaxhmentit: Pajtohet

[1] Çështja A dhe rekomandimi A-nënkuptojnë çështjet dhe rekomandimet e reja;
Çështja B dhe rekomandimi B-nënkuptojnë çështjet dhe rekomandimet e përsëritura;
Çështja C dhe rekomandimi C-nënkuptojnë çështjet dhe rekomandimet pjesërisht të përsëritura.

1.3 Gjetjet për çështjet e kontabilitetit dhe të pajtueshmërisë

Politikat dhe procedurat kontabël

Çështja A1 - Mungesa e një udhëzuesi për politikat dhe procedurat kontabël

Kriteri Paragrafi 13 i SNK 8 "Politikat Kontabël, Ndryshimet në Vlerësimet Kontabël dhe Gabimet" kërkon që njësitë ekonomike të zgjedhin politika kontabël të qarta dhe të qëndrueshme dhe saktëson se "Një njësi ekonomike duhet të zgjedh dhe zbatoj politikat e saj kontabël me qëndrueshmëri për transaksionet, ngjarjet dhe kushtet e tjera të ngjashme. Duke ju referuar një kërkese të tillë nga standardi, politikat kontabël janë parimet, bazat, marrëveshjet, rregullat dhe praktikat e veçanta që zbatohen nga një njësi ekonomike në përgatitjen dhe paraqitjen e pasqyrave financiare. Ato përfshijnë gjykime të bazuara në informacionet më të fundit të besueshme, të disponueshme.

Gjetja: Edhe përkundër faktit se ndërmarrja ka një numër të rregulloreve sipas kërkesave të Ligjit për Ndërmarrjet Publike, ajo ende nuk ka politika të qarta dhe të qëndrueshme të gjykimeve dhe vlerësimeve kontabël të përmbledhura për t'i përdorur për hartimin e pasqyrave financiare vjetore.

Kjo çështje ishte ngritur gjatë auditimit dhe menaxhmenti është dakorduar që t'i hartoj këto politika për përgatitjen e PFV. Deri më tani bordi i drejtorëve të ndërmarrjes ende nuk kishte aprovuar politika të tilla, por zotimi i menaxhmentit është se janë duke punuar në hartimin e tyre.

Ndikimi Mungesa e politikave dhe procedurave kontabël ndikon në ecurinë e përgatitjes së PFV-ve duke mos krijuar parakushte për parandalimin e keq deklarimeve të zërave material. Po ashtu, në mungesë të politikave të qarta dhe vlerësimeve kontabël mund të rrezikohen objektivat strategjike të ndërmarrjes.

Rekomandimi A1 Bordi i drejtorëve të sigurojë hartimin dhe miratimin e udhëzuesit të politikave dhe procedurave kontabël dhe zbatimin e tij në mbajtjen e librave kontabël dhe raportim financiar.

Përgjigjja e menaxhmentit: Pajtohet

Pasuritë afatshkurtra

Vlera neto e zërit financiar të pasurive afatshkurtra e prezantuar në pasqyrën e pozitës financiare ishte 2,495,850€. Ato kanë të bëjnë kryesisht me llogaritë e arkëtueshme tregtare, të prezantuara në vlerë prej 1,463,581€, paranë e gatshme në arkë dhe llogarinë bankare në vlerë prej 111,501€, stoqet në vlerë prej 438,169€, si dhe pasuritë afatshkurtra-paradhëniet dhe parapagimet në vlerë 28,924€. Kemi testuar 57 mostra për testim substancial dhe 6 për testim të pajtueshmërisë për vitin 2019 në llogaritë e arkëtueshme tregtare, paranë e gatshme, stoqet dhe parapagimet. Vlera totale e testeve substanciale është 614,206€.

Çështja A2 - Mos barazimi i evidencave kontabël dhe letër konfirmimeve për të arkëtueshmet

Kriteri Sipas SNK 1 një njësi ekonomike duhet të japë informacion shpjegues, ose në pasqyrën e pozicionit financiar ose në shënimet shpjeguese, për nën klasifikime të mëtejshme të zërave të paraqitur, klasifikuar në një mënyrë të përshtatshme për operacionet e njësisë ekonomike. Të dhënat e kontabilitetit duhet të jenë burim i besueshëm për hartimin e pasqyrave financiare.

Gjetja Llogaritë e arkëtueshme tregtare dhe të tjera në pasqyra financiare janë prezantuar me vlerë 1,463,580€. Për të testuar saktësinë e tyre ne kemi dërguar shtatë (7) letër konfirmime te palët e treta-klientët në vlerë të përbashkët prej 955,273€, ndërsa ne kemi pranuar vetëm tre (3) letër konfirmime me vlerë prej 932,600€, nga të cilat njëra ka rezultuar me nënvlerësim të kartelës së klientit në vlerë prej 13,071€. Ndërsa nga katër (4) klientët tjerë nuk kemi pranuar fare konfirmimet.

Ndikimi Mungesa e kontrolleve adekuate në sistemin e kontabilitetit si dhe mos harmonizimi periodik i të dhënave të ndërmarrjes dhe klientëve të saj ndikon në prezantim jo të drejtë të informatave në pasqyra financiare.

Rekomandimi A2 Bordi i drejtorëve duhet të sigurojë se janë marrë veprimet e nevojshme për harmonizimin e të dhënave ndërmjet ndërmarrjes dhe klientëve të saj në baza periodike në mënyrë që të sigurohet informacioni i saktë i vlerës së llogarive të arkëtueshme.

Përgjigjja e menaxhmentit: Pajtohet

Çështja B2 - Mos harmonizim i raportit të komisionit të inventarizimit me regjistrat kontabël të stoqeve.

Kriteri Sipas Ligjit Nr.06/L- 032 për kontabilitet, raportim financiar dhe auditim, shoqëritë tregtare të paktën një herë në vit duhet të verifikojnë ekzistencën dhe vlerësimin e pasurive, detyrimeve dhe kapitalit, nëpërmjet inventarizimit të këtyre elementeve dhe dëshmive të tyre mbështetëse nëpërmjet procesit të inventarizimit. Rezultatet nga raporti i inventarizimit duhet të barazohen me librat kontabël.

Gjetja Komisioni për inventarizimin e pasurisë në fund të vitit kishte bërë regjistrimin e pasurisë përfshirë këtu edhe stoqet dhe kishte përpiluar raportin final të inventarizimit. Ne krahasuam raportin e komisionit të inventarizimit me shënimet kontabël dhe pasqyrat financiare dhe konstatuam se ekziston një mbivlerësim i stoqeve në vlerë prej 4,957€ mes gjendjes fizike të tyre kundrejt shënimeve kontabël. Për më tepër komisioni nuk kishte verifikuar fare stokun e pjesëve rezervë të papërdorura dhe stokun e biletave të papërdorura.

Kjo kishte ndodhur për shkak të mos regjistrimit të stokut me vlerë të përbashkët prej 2,588€ në dy depo nga komisioni për inventarizim, ndërsa pjesa tjetër në vlerë prej 2,369€, ishte shkaktuar nga mos harmonizimi i shënimeve kontabël me gjendjen faktike të tyre.

Ndikimi Mos inventarizimi i të gjitha njësive si dhe mos harmonizimi i gjendjes fizike të stoqeve dhe shënimeve kontabël për to, reflekton me pasqyrim të gjendjes jo reale të pasurisë në pasqyrën e pozicionit financiar të ndërmarrjes.

Rekomandimi B2 Bordi i drejtorëve duhet të sigurojë se bëhen barazimet e gjendjes së stoqeve në evidencat kontabël me gjendjen faktike të tyre si dhe të shtoj kontrollet për përcjelljen e gjendjes së stoqeve, në mënyrë që të sigurohet saktësia e vlerës së tyre për tu prezantuar saktë në pasqyrat financiare.

Përgjigjja e menaxhmentit: Pajtohet

Çështja B3 - Mos harmonizim i stokut të naftës me regjistrat kontabël të stoqeve.

Kriteri Sipas Ligjit Nr. 06/L- 032 për kontabilitet, raportim financiar dhe auditim, shoqëritë tregtare të paktën një herë në vit duhet të verifikojnë ekzistencën dhe vlerësimin e pasurive, detyrimeve dhe kapitalit, nëpërmjet inventarizimit të këtyre elementeve dhe dëshmive të tyre mbështetëse nëpërmjet procesit të inventarizimit. Rezultatet nga raporti i inventarizimit duhet të barazohen me librat kontabël.

Gjetja Komisioni për numërimin e stoqeve në fund të vitit kishte bërë regjistrimin e sasisë së naftës në depon qendrore. Komisioni kishte konstatuar një diferencë pozitive në gjendjen faktike të naftës në rezervuar për sasinë 4,672 litra apo në vlerë 3,831€ krahasuar me shënimet kontabël. Për diferencën në vlerë 3,831€, ishte nënvlerësuar zëri i stoqeve. Ndërmarrja këtë diferencë pozitive të stokut të naftës e kishte njohur në kontabilitet si të hyrë me ç 'rast kishte mbivlerësuar edhe të hyrat për të njëjtën shumë.

Sipas zyrtarit kryesor të depos, kjo situatë ka ndodhur si shkak i mungesës së aparaturës adekuate për matje të sasisë së naftës pasi që aparaturat aktuale janë shumë të vjetruara dhe nuk kanë saktësinë e duhur gjatë procesit të matjes së naftës.

Ndikimi Mos harmonizimi i gjendjes fizike të stokut të naftës dhe shënimeve kontabël reflekton me pasqyrim të gjendjes jo reale të pasurisë në pasqyrën e pozicionit financiar të kompanisë.

Rekomandimi B3 Bordi i drejtorëve duhet të sigurojë që bëhet harmonizimi i sasisë fizike të naftës me regjistrat kontabël, për të siguruar saktësinë e vlerës së naftës, të stoqeve dhe rrjedhimisht të pasurive të prezantuar në pasqyrat financiare.

Përgjigjja e menaxhmentit: Pajtohet

Çështja B4 - Parapagimet e periudhave të mëhershme

Kriteri Sipas SNK 1 shpenzimet e parapaguara shfaqen atëherë kur paguhet paraja para se të përdoret artikulli, shërbimi apo dobia, ndërsa shpenzimet përkatëse njihen gjatë periudhës përkatëse të pranimit të tyre.

Gjetja Zëri i parapagimeve në pasqyrën e pozitës financiare është prezantuar në vlerë 14,051€. Kjo vlerë e prezantuar e këtij zëri sipas zyrtarëve të ndërmarrjes është bartje nga periudhat e mëhershme kontabël dhe datojnë prej vitit 2014 dhe 2015 në regjistrat kontabël. Testimi ynë mbi këtë zë është fokusuar në parimin e të drejtave dhe detyrimeve të konstatuara dhe përderisa këto parapagime mbahen në bilancin e ndërmarrjes si aktive, duhet të ekzistojë një e drejtë për të cilën ndërmarrja i pret ende shërbimet nga furnizimet. Ndërmarrja nuk kishte dokumentacion e as informacion kredibil për të vërtetuar të drejtat e saj ndaj furnitorëve të listuar në këtë llogari.

Ndikimi Mungesa e kontrolleve efektive në trajtimin e parapagimeve si dhe mungesa e evidencave të cilat e konstatojnë të drejtën e ndërmarrjes mbi to, ndikon në prezantim jo të drejtë të tyre në pasqyrën e pozitës financiare.

Rekomandimi B4 Bordi i drejtorëve të sigurojë se ekzistojnë dëshmi valide dhe kredibile për të konfirmuar të drejtat e ndërmarrjes për këto parapagime. Në të kundërtën në qoftë se nuk konstatohen të drejtat e ndërmarrjes për këta furnitorë të sigurojë se janë larguar nga regjistri i parapagimeve të ndërmarrjes.

Përgjigjja e menaxhmentit: Pajtohet

Detyrimet afatshkurtra

Vlera neto e zërit financiar të detyrimeve afatshkurtra e prezantuar në pasqyrën e pozitës financiare ishte 1,678,548€. Ato kanë të bëjnë me llogaritë e pagueshme tregtare ndaj furnitorëve, më vlerë 1,144,458€ dhe detyrime ndaj të punësuarve dhe për tatime dhe kontribute në paga me vlerë 534,090€. Ne kemi testuar 32 mostra për testim substancial dhe shtatë për testim të pajtueshmërisë për vitin 2019 në llogarite e pagueshme. Vlera totale e testeve substanciale ishte 553,151€.

Çështja A3 - Mos pagimi i faturave brenda afatit të kontraktuar

Kriteri Në marrëveshjen e lidhur ndërmjet Trainkos dhe Infrakos sh.a për ofrimin e shërbimeve të përbashkëta dhe pagesën e tyre, pika 13 përkufizon se pagesat e faturave duhet të bëhen më së largu brenda 30 ditësh nga dita e pranimit të faturave të protokolluara nga arkivat përgjegjëse të dy ndërmarrjeve.

Gjetja Gjatë auditimit kemi vërtetuar se Trainkos në tri (3) fatura me vlerë të përbashkët prej 85,553€ të cilat i kishte pranuar në muajt mars, prill dhe dhjetor 2019, nuk i kishte paguar brenda afatit kohor 30 ditësh pas pranimit të faturës nga Infrakos sh.a. Këto fatura ishin raportuar si detyrim në pasqyrat financiare të 2019, dhe nuk ishin paguar as edhe në tre mujorin e parë të vitit 2020.

Kjo sipas zyrtarëve përgjegjës kishte ndodhur për shkak të buxhetit të pamjaftueshëm.

Ndikimi Mos pagesa e faturave ndaj operatorëve ekonomik nga ndërmarrja brenda afateve kohor të përcaktuara në kontratë rrit mundësinë e padive, apo shlyerjen e borxhit përmes përmbaruesve privat e cila mund të shkaktoj kosto shtesë për ndërmarrjen.

Rekomandimi A3 Bordi i drejtorëve të sigurojë që të gjitha detyrimet ndaj operatorëve ekonomik paguhen brenda afateve kohore të dakorduara në kushtet e kontratës në mes dy palëve.

Përgjigjja e menaxhmentit: Pajtohet

Çështja A4 - Mos prezantim i saktë i llogarive të pagueshme

Kriteri	Sipas SNK 1, Llogaritë e pagueshme tregtare dhe të pagueshmet tjera njihen në vlerën reale të tyre. Llogaritë e pagueshme tregtare janë detyrime që krijohen gjatë kryerjes së aktiviteteve kryesore të njësisë ekonomike. Ato krijohen si pasojë e blerjes së mallrave apo shërbimeve me pagesë të mëvonshme.
Gjetja	Llogaritë e pagueshme në pasqyrën e pozitës financiare janë prezantuar në vlerë 1,144,458€, ndërsa në shënimet kontabël të ndërmarrjes në zërin e llogarive të pagueshme ishte vlera 1,146,363€. Duke rezultuar me nënvlerësimin e llogarive të pagueshme në pasqyrën financiare për vlerën 1,905€. Kjo diferencë kishte ndodhur për shkak të pakujdesisë së bartjes së shifrave nga shënimet e kontabilitetit në pasqyrat financiare.
Ndikimi	Prezantimi jo i drejtë i llogarive të pagueshme në pasqyrën e pozitës financiare, ndikon në cilësinë e pasqyrave financiare, kufizon përdoruesit e tyre për ta kuptuar gjendjen e drejtë dhe të vërtetë të rezultateve financiare të ndërmarrjes.
Rekomandimi A4	Bordi i drejtorëve duhet të sigurojë se llogaritë e pagueshme barten dhe prezantohen me vlerën e tyre reale në pasqyrat financiare.

Përgjigjja e menaxhmentit: Pajtohet

Të hyrat

Të hyrat e realizuara ishin në vlerë 4,302,126€. Ato kanë të bëjnë me të hyrat nga transporti i mallrave, udhëtarëve, të hyrat nga Ministria e Infrastrukturës dhe Ministria e Zhvillimit Ekonomik si dhe të hyrat nga aktivitetet tjera. Kemi testuar 53 mostra për teste substanciale të detajeve në vlerë 821,536€ si dhe 37 mostra për teste të pajtueshmërisë.

Çështja B5 - Ofrimi i shërbimeve (shitja e naftës) jashtë fushëveprimit dhe aktiviteteve të ndërmarrjes

Kriteri Trainkos me statut ka përcaktuar që aktivitetet e saj të jenë si në vijim: menaxhimi, operimi dhe ofrimi i shërbimeve për transportin për udhëtar dhe mallra, pastaj ofrimi i shërbimeve të mirëmbajtjes dhe renovimit të të gjitha mjeteve lëvizëse për institucionet tjera jashtë hekurudhës. Nga këto aktivitete Trainkos gjeneron të hyra.

Gjetja Trainkos gjatë vitin 2019, ka realizuar të hyra tjera duke shitur naftë ndërmarrjes publike Infrakos sh.a në shumë prej 37,527€. Këto të hyra Trainkos i kishte realizuar jashtë kornizës statutore të saj, rrjedhimisht edhe jashtë planit të biznesit. Shitjen e naftës Trainkos e kishte bërë duke u bazuar në marrëveshjen për shërbime të përbashkëta mes Trainkos dhe Infrakos sh.a. të datës 16.04.2019[2]. Për më tepër Trainkos naftën ia shet Infrakos sh.a me çmim të furnizimit pa aplikuar ndonjë tarifë shtesë për kostot e ruajtjes, magazinimit dhe sigurimit në rezervuarët e saj.

Ndikimi Aktivitetet të cilat zhvillohen në kundërshtim me statutin dhe planin e biznesit ndikojnë në zvogëlimin e vëmendjes në fushat kryesore ku gjenerohen të hyrat. Për më tepër gjenerimi i të hyrave jashtë mandatit statutor rrezikon të sanksionohet nga autoritetet kompetente për mbikëqyrjen e tregut.

Rekomandimi B5 Bordi i drejtorëve të siguroj se ofrimi i shërbimeve bëhet vetëm për ato veprimtari të cilat janë të përcaktuara me statut dhe të marr masat e duhura për ndërprerjen e shitjes së naftës ndaj ndërmarrjes tjetër. Poashtu të rishikojë marrëveshjen duke i përjashtuar të gjitha ato punë dhe shërbime që mund të ofrohen direkt nga operator tjerë ekonomik dhe që nuk janë veprimtari statutore e ndërmarrjes.

Përgjigjja e menaxhmentit: Pajtohet

[2] Në marrëveshjen për shërbime të përbashkëta përcaktohen disa nga kostot të cilat duhet të ndahen nga dy ndërmarrjet (Trainkos dhe Infrakos sh.a.) siç janë: Energjia elektrike, interneti, telefonia fikse, qiraja, mbeturinat, radiolidhjet, ngrohja, transporti gratis për punëtoret e dy ndërmarrjeve, karburantet, mirëmbajtja e binarëve si dhe përdorimi i makinerisë për ngarkim shkarkim.

Shpenzimet

Në pasqyrën e të ardhurave gjithëpërfshirëse shpenzimet në total kapin vlerën 4,462,989€, struktura e tyre grupore është si vijon: shpenzimet e personelit 1,811,202€, kostot e shitjes 1,261,977€, shpenzimet e zhvlerësimit 1,063,822€, dhe shpenzimet administrative dhe të tjera 325,988€. Kemi testuar 68 mostra për teste substanciale në shumën 342,234€ si dhe 27 mostra për teste të pajtueshmërisë.

Çështja A5 - Mos emërimi i menaxherit të kontratës

Kriteri Në Udhëzuesin Operativ për Prokurim Publik paragrafi 4 i nenit 61 përcakton se pasi të jetë nënshkruar kontrata nga të dy palët, Zyrtari përgjegjës i Prokurimit do ta informojë me shkrim Zyrtarin Kryesor Administrativ dhe i cili do ta emërojë një Menaxher të Projektit përgjegjës për menaxhimin (mbikëqyrjen) e kontratës specifike.

Gjetja Trainkos kishte nënshkruar kontratën me vlerë 23,290€ për "Furnizim me senzorë dhe regjistrues të shpejtësisë për lokomotiva". Me këtë rast zyrtari përgjegjës i prokurimit nuk e kishte informuar Zyrtarin Kryesor Administrativ që për këtë furnizim të emëroi një menaxher të kontratës dhe si rrjedhoje për këtë kontratë nuk kishte emëruar fare menaxher të kontratës.

Mos emërimi i menaxherit të kontratës kishte ndodhur për shkak se kontrata kishte të bëjë me një furnizim dhe për këtë arsye zyrtari përgjegjës i prokurimit nuk e kishte parë të arsyeshme që të informoj Kryeshefin Ekzekutiv për të caktuar një menaxher të kontratës për ketë blerje.

Ndikimi Mos emërimi i menaxherit të kontratës ndikon në zvogëlimin e sigurisë se kontrata është realizuar konform specifikave të parapara.

Rekomandimi A5 Bordi i drejtorëve të siguroi se për çdo kontratë publike me vlerë të madhe dhe të mesme është caktuar menaxheri i kontratës për përcjelljen e procesit të mbarëvajtjes së furnizimit, pasi të jetë nënshkruar kontrata nga të dy palët.

Përgjigjja e menaxhmentit: Pajtohet

Njësia e Auditimit të Brendshëm

Njësia e Auditimit të Brendshëm (NjAB) operon me një Zyrtare të Auditimit. Për të kryer një auditim efektiv nevojitet një program gjithëpërfshirës i punës i cili reflekton rreziqet financiare dhe të tjera të ndërmarrjes dhe ofron siguri të mjaftueshme mbi efektivitetin e kontrollit të brendshëm. Ndikimi i produkteve të Auditimit të brendshëm duhet të gjykohet nga rëndësia që i jep Menaxhmenti zbatimit të rekomandimeve të auditimit.

NJAB kishte përgatitur planin vjetor ku kishte planifikuar gjashtë auditime. Prej tyre gjashtë raporte kishin përfunduar gjatë vitit 2019. Komiteti i auditimit kishte mbajtur katër takime dhe kishte shqyrtuar raportet e NjAB-së.

Në përgjithësi puna e AB ishte e fokusuar në fushat me rrezik, si në shpenzime, të hyra, personel etj. Po ashtu edhe mbulueshmëria e vitit aktual ishte dominuese, që i ofronte siguri menaxhmentit për funksionimin e kontrolleve të brendshme. Nuk kemi ndonjë çështje apo rekomandim te kjo njësi.

3 Çështjet e zgjidhura gjatë ciklit të auditimit

Ne gjithashtu gjetëm çështje që iu komunikuan menaxhmentit dhe u zgjidhën në mënyrë efektive gjatë auditimit aktual. Ato nuk kërkojnë ndonjë veprim të mëtutjeshëm dhe raportohen vetëm me qëllim të dokumentimit të komunikimit në fjalë, veprimeve të ndërmarra dhe rezultateve të tyre. Këto ishin si më poshtë:

Çështja A6 - Korrigjimet e shënimeve shpjeguese dhe disa zërave në pasqyra financiare

Gjetja

Sipas SNK1, Shënimet shpjeguese, paraqesin informacion lidhur me bazën e përgatitjes së pasqyrave financiare dhe politikave kontabël dhe japin informacione shtesë të cilat nuk janë paraqitur në pasqyrën e pozitës financiare, pasqyrën e të ardhurave, pasqyrën e rrjedhës së parasë ose pasqyrën e ndryshimeve në ekuitet, por janë të rëndësishme për t'i kuptuar cilëndo prej tyre.

Trainkos kishte miratuar versionin e parë të pasqyrave financiare vjetore dhe na ofroi më datë 19.04.2020. Në këto pasqyra nga analizat tona u konstatuan disa gabime të cilat ishin të mundshme dhe kishin nevojë të korrigjoheshin. Më saktësisht mungonin shënimet mbi politikat kontabël përmbledhëse të ndërmarrjes, po ashtu edhe shënimet shpjeguese në disa nga zërat material nuk ishin sqaruar mjaftueshëm për përdoruesit e pasqyrave financiare, në disa raste ju kanë munguar edhe shumat krahasuese me periudhën paraprake dhe në dy raste ndërlidhja e referencave me pasqyrën e pozitës financiare nuk ishin të sakta. Edhe pasqyra e rrjedhës së parasë nuk ishte e plotë në zërat e aktiviteteve operative të cilat nuk kishin përfshirë rregullimet për zërin e shpenzimeve të zhvlerësimit dhe rrjedhimisht u konstatuan disa diferenca.

Veprimi i kërkuar Gjatë auditimit ne i rekomanduam menaxhmentit që të bëjë këto plotësime dhe korrigjime të nevojshme në shënimet shpjeguese të PFV.

Rezultati Bordi i drejtorëve në bashkëpunim më menaxhmentin dhe zyrtarin kryesor financiar kanë adresuar këtë çështje, duke korrigjuar zërat dhe shënimet shpjeguese të cilët nuk ishin prezantuar saktë në versionin e parë të PFV-ve dhe më datë 05.06.2020 ka miratuar versionin e korrigjuar të tyre.

Nënshkruar nga:

Besnik Osmani

Auditor i Përgjithshëm

Data: 02.07.2020

Zyra Kombëtare e Auditimit

Adresa: Rr. Ahmet Krasniqi, 210

Prishtinë, Kosovë

NAP/ Drejtori/UE

Arvita Zyferi

Enver Boqolli

Fejzullah Fejza

Shtojca I: Statusi i zbatimit të rekomandimeve të vitit(eve) paraprak(e)

Raporti i auditimit për PFV-të e vitit 2018 të ndërmarrjen ka rezultuar me 17 rekomandime kryesore. Kompania kishte përgatitur një Plan Veprimi ku paraqiten mënyra se si do t'i zbatonin rekomandimet.

Deri në fund të auditimit tonë për vitin 2019, 7 rekomandime ishin zbatuar plotësisht, 1 rekomandim ishte mbyllur i pa zbatuar, 3 rekomandime ishin zbatuar pjesërisht, ndërsa 6 nuk ishin adresuar ende. Për një përshkrim më të plotë të rekomandimeve dhe mënyrën se si janë trajtuar ato, shihni në Tabelën në vijim.

Tabela 1. Përmbledhja e rekomandimeve për vitin 2018 dhe vitin 2019

Nr.	Fusha e Auditimit	Rekomandimet e vitit 2018	Veprimet e ndërmarra	Statusi
1	PFV	Kryesuesi i Bordit të sigurojë se zërat përbërës të pasqyrës së rrjedhës së parasë janë prezantuar drejtë nëpër aktivitetet përkatëse operative, investuese dhe financuese dhe janë dhënë sqarimet e nevojshme në shënimet shpjeguese të PFV-ve.	Para se të nënshkruhen PVF, është kryer një rishikim për të gjithë zërat me qëllim të vërtetimit të saktësisë së informacionit financiar.-shih PVF finale 2019	I zbatuar
2	PFV	Kryesuesi i bordit duhet të siguroi se janë ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme të komunikimit dhe bashkëpunimit me klientët borxhli, në mënyrë që të sigurohen me kohë konfirmimet ndaj auditorit lidhur me vlerën e detyrimeve ndaj Trainkos-it.	Është rritur komunikimi mes ndërmarrjes dhe klientëve dhe furnitorëve por ende nuk është në nivel të dëshiruar.	Pjesërisht i zbatuar
3	PFV	Kryesuesi i Bordit duhet të siguroj që janë marrë të gjitha masat e nevojshme për të kryer rivlerësimin e pasurive fikse dhe kjo të bëhet së paku njëherë në pesë (5) vite për ta vërtetuar vlerën e saktë të pasurive në përputhje me SNK 16.	Për mungesë të mjeteve financiare nuk është filluar ky proces.	I pa zbatuar
4	PFV	Kryesuesi i Bordit duhet të siguroj se është bërë një analizë për t'i përcaktuar shkaqet të cilat kanë ndikuar tek dhënia e Opinionit të Kualifikuar dhe do të merren veprimet e nevojshme për eliminimin e tyre. Gjithashtu, kryesuesi i bordit duhet të siguroj se janë vendosur procese efektive për të konfirmuar që procesi i hartimit të PFV-ve për vitin 2019 i adreson të gjitha çështjet që kanë të bëjnë me pajtueshmërinë. Kjo, gjithashtu duhet të përfshijë rishikimin e draft PFV-ve nga menaxhmenti, me fokus të veçantë në fushat me rrezik të lartë dhe në fushat ku janë identifikuar gabime në vitet e mëparshme. Nënshkrimi i pasqyrave nga KE dhe ZKFTH, nuk duhet të	Ndërmarrja ka marrë veprime për të korrigjuar draft PVF, mirëpo ende nuk ka arritur të eliminoj të gjitha çështjet që reflektojnë në opinion të modifikuar.	Pjesërisht i zbatuar

		bëhet përveç nëse ndaj PFV-ve janë aplikuar të gjitha kontrollet e nevojshme para se të njëjtat t'i dorëzohen BD-së.		
5	Plani i biznesit	Kryesuesi i Bordit duhet të siguroj se me rastin e rishikimit të planit të biznesit, bëhen analiza më të sakta lidhur me gjenerimin e të hyrave nëpër secilën kategori. Poashtu të bëhet një analizë e detajuar aktiviteteve investuese të planifikuara për tu realizuar gjatë vitit dhe të merren veprimet e nevojshme që këto projekte të realizohen sipas planit.	Ndërmarrja ka marrë veprimet me rastin e rishikimit të planit të biznesit.	I mbyllur i pa zbatuar
6	Pasqyra e pozitës financiare	Kryesuesi i Bordit duhet të siguroj që bëhen barazimet e gjendjes së stoqeve në evidencat kontabël me gjendjen e tyre faktike si dhe të sigurojë se janë shtuar kontrollet për monitorimin e vazhdueshëm të tyre. Po ashtu kurdo që paraqiten diferenca të tilla të vazhdohet me hulumtimin e tyre deri të identifikohen diferencat dhe shkaktarët.	Për kundër përmirësimeve në këtë fushë ende ekzistojnë mangësi mes gjendjes faktike dhe regjistrit kontabël.	I pa zbatuar
7	Pasqyra e pozitës financiare	Kryesuesi i Bordit duhet të sigurojë që korrigjimet e efekteve nga periudhat paraprake të reflektohen edhe në kolonën e vitit paraardhës e jo vetëm në atë të vitit raportues. Gjithashtu të shpalosen në shënimet shpjeguese të pasqyrave arsyet dhe efektet e korrigjimit për secilin zë të pasqyrave.	Janë marrë parasysh dhe janë bërë korrigjimet e duhura në vitet e mëhershme.	I zbatuar
8	Pasqyra e pozitës financiare	Kryesuesi i Bordit duhet të ndërmarrë veprime adekuate për qartësimin e situatës në mes të dy kompanive dhe të siguroj dokumentacionin e nevojshëm që mbështet vlerën e parapagimeve në mënyrë që të realizoj këtë vlerë përmes marrjes së mallit apo shërbimit për to.	Nuk është marrë asnjë veprim.	I pa zbatuar
9	Pasqyra e pozitës financiare	Kryesuesi i Bordit duhet të marrë veprimet e nevojshme për hartimin e një rregulloreje për trajtimin e provizioneve dhe borxheve të këqija të bazuar në politika të qarta dhe në harmoni me Standardet e kontabilitetit.	Është hartuar rregullorja për provizionim të borxheve të këqija dhe të dyshimta.	I zbatuar

10	Pasqyra e të ardhurave	Kryesuesi i Bordit duhet të siguroj se menaxheri i kontratës përgatit formën standarde të menaxhimit të secilit projekt me qëllim të raportimit të saktë të situacioneve të kryera dhe lehtësimit të monitorimit nga organet kompetente dhe palët e interesit.	Janë hartuar planet e menaxhimit të kontratës konformë formës standarde të kësaj fushe.	I zbatuar
11	Pasqyra e të ardhurave	Kryesuesi i Bordit duhet të siguroj se bëhet identifikimi i nevojave për furnizime nga të gjitha njësitë kërkuese dhe të njëjtat përfshihen në planin vjetor të prokurimit. Përgatitja adekuate e planeve për furnizime ndihmon në zhvillimin e procedurave adekuate dhe shtim të vlerës për para.	Është bërë një përmbledhje e nevojave nga njësitë kërkuese në mënyrë që mos të këtë procedura me vlera minimale.	I zbatuar
12	Pasqyra e të ardhurave	Kryesuesi i Bordit duhet të siguroj që zyra e financave regjistrojnë transaksionet në mënyrë të drejtë duke interpretuar drejtë standardet e kontabilitetit. Po ashtu duhet të sigurojë që plani kontabël përmban të gjithë zërat që mbulojnë transaksionet e Kompanisë në përputhje me kërkesat e SNK-ve.	Nuk janë marrë masat për përmirësim.	I pa zbatuar
13	Pasqyra e të ardhurave	Kryesuesi i Bordit duhet të siguroj se çdo faturë kontrollohet me kujdesin e duhur nga zyrtarët përgjegjës para se të procedohet më tutje në kontabilitet, ndërsa për rastet e identifikuara me gabime të kërkojnë që të bëhen korrigjimet e nevojshme për t'i eliminuar efektet e gabimit.	Janë kryer korrigjimet e gabimeve të konstatuara, dhe është shtuar kujdesi në regjistrimet kontabël.	I zbatuar
14	Pasqyra e të ardhurave	Kryesuesi i Bordit duhet të siguroi së janë marrë masat e nevojshme që mjetet e matjes së naftës të jenë të kalibruara dhe bëjnë matje të saktë, si dhe vëzhgimi i kamerave të jetë funksional gjatë gjithë kohës. Gjithashtu në periudha më të shpeshta të bëhen matjet e sasive në rezervar të naftës dhe të bëhet harmonizimi i shënimeve të kontabilitetit me gjendjen reale në mënyrë që të identifikohen dhe eliminohen me kohë humbjet e mundshme.	Nuk janë marrë masat për përmirësim.	I pa zbatuar
15	Pasqyra e të ardhurave	Kryesuesi i Bordit duhet të siguroj se ofrimi i shërbimeve bëhet vetëm për ato veprimtari të cilat janë të përcaktuara me statut dhe të marr masat e duhura për ndërprerjen e shitjes së	Nuk janë marrë masat për përmirësim.	I pa zbatuar

		naftës ndaj kompanisë tjetër deri sa kjo nuk është e përfshirë në fushë veprimtarinë e Trainkos-it.		
16	Pasqyra e ndryshimeve në ekuitet	Bordi i Drejtoreve duhet të siguroj se ndryshimi i zërave të prezantuar në pasqyrën e ekuitetit referencohen dhe jepen sqarimet e nevojshme në shënimet shpjeguese për çdo ndryshim rreth tyre.	Janë marrë masa të duhura që mos të ketë zëra të cilët nuk janë sqaruar në shënimet shpjeguese.	I zbatuar
17	Shënimet shpjeguese	Kryesuesi i Bordit duhet të siguroj se gjatë hartimit të PFV-ve shënimet shpjeguese do të prezantojnë të gjitha informacionet e detajuara, të plota dhe të sakta sipas kërkesave të standardeve të kontabilitetit. Për më tepër, ato nuk duhet të miratohen pa një rishikim të hollësishëm të të gjithë zërave të pasqyrave financiare si dhe pa plotësinë dhe saktësinë e shënimeve shpjeguese.	Është bërë një progres në përpilimin e shënimeve shpjeguese, mirëpo ende ka nevojë për trajtimin e disa lëshimeve në këtë periudhë.	Pjesërisht i zbatuar

Nr.	Fusha e auditimit	Rekomandimet e vitit 2019
1	Baza për opinion	Bordi i drejtorëve të sigurojë një rishikim gjithëpërfshirës të regjistrit të pasurisë dhe të ndërmarrë veprime konkrete për rivlerësimin dhe rishikimin e jetës së dobishme të pasurive së paku një herë në (5) pesë vite. Kjo me qëllim të paraqitjes së vlerës reale të pasurive, në përputhje me kërkesat e SNK 16.
2	Politikat dhe procedurat kontabël	Bordi i drejtorëve të sigurojë hartimin dhe miratimin e udhëzuesit të politikave dhe procedurave kontabël dhe zbatimin e tij në mbajtjen e librave kontabël dhe raportim financiar.
